



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore  
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-020/04-0017550-2/26 dt. 14.04.2026  
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, nenet 20, 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, dhe Propozim-Vendimin Nr. 01-020/04-0017550/26, dt. 02.04.2026, të Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm, Kryetari i Komunës sjell këtë:

#### V E N D I M

**(Për formimin e Komisionit për Përgatitjen e Programit 3 (tre) Vjeçar të Banimit për vitet 2026-2029 për Komunën e Mitrovicës Jugore)**

1. Formohet Komisioni për Përgatitjen e Programit 3 (tre) Vjeçar të Banimit për vitet 2026-2029 për Komunën e Mitrovicës Jugore, në këtë përbërje:
  - 1.1. Sebahate Tahiri - kryesuese, Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm;
  - 1.2. Nexhat Rushiti – anëtar, Drejtoria për Mirëqenie Sociale;
  - 1.3. Berat Jashari – anëtar, Drejtoria për Shëndetësi;
  - 1.4. Naser Shala – anëtar, Drejtoria për Buxhet dhe Financa;
  - 1.5. Izet Haxha – anëtar, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
2. Detyrë e Komisionit të formuar sipas pikës 1 (një) të këtij Vendimi është përgatitja e Programit 3 (tre) Vjeçar të Banimit për vitet 2026-2029.
3. Komisioni obligohet që pas Përgatitjes së Programit 3 (tre) Vjeçar të Banimit dhe të kompletimit të dokumentacionit përcjellës, të njëjtin t'a procedojë për miratim në Kuvend, përmes Kryetarit të Komunës.
4. Komisioni i lartcekur bazë për punën e tij do të ketë Ligjin Nr. 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, dhe dispozitat tjera ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi.



5. Mandati i Komisionit do të zgjasë nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij Vendimi gjerë në përfundim të detyrave të përcaktuara me këtë Vendim.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryetari i Komunës

Faton PEÇI



**Shtojcë:**

Propozim-Vendimi i DPU-së Nr. 01-020/04-0017550/26, dt. 02.04.2026;  
E-maili nga znj. Sebahate Tahiri, DPU, dt. 08.04.2026.

**T'i dorëzohet:**

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Zyrës Ligjore
- 1x1 Zyrës për Informim
- 1x1 Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm
- 1x1 Anëtarëve të Komisionit
- 1x1 Arkivit

